



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.19, datë 13.01.2020

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION I BAZAMENTIT TË LINJËS SË COPËZIMIT TË
FERROKROMIT”, ME VENDNDODHJE BRENDIA TERRITORIT TË UZINËS SË
FERROKROMIT ELBASAN, BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Albchrome” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion i bazamentit të linjës së copëzimit të ferrokromit”, me vendndodhje brenda territorit të Uzinës së Ferrokromit Elbasan, Bashkia Elbasan , me subjekt zhvillues shoqërinë “Albchrome” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Elbasan.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU




ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

